

RAPORTI I

KOMISIONIT TË STUDIMEVE TË SHKRIMEVE TË SHENJËTA

PËR

ASAMBLËN E PËRGJITHSHME TË NJËZET E TETË

të

KISHËS NAZARETE

19-28 Qershor 2013

Indianapolis, Indiana, USA

Komisioni i Studimeve të Shkrimeve të Shenjta

ANTARËT E KOMISIONIT

Gary Bennett, Stephen Dillman, Bradley Estep, Thomas King (kryetar), Joseph Knight, Melvin McCullough, Jesse C. Middendorf, Thomas Noble, Christian Samiento, Arthur Snijders, Alexander Varughese (sekretar) dhe David Wilson; me ndihmë të vlefshme nga Stan Ingersol dhe Shirley Marvin.

PASQYRA

Bordi i Mbikqyrësve të Përgjithshëm i ka caktuar Komisionit të Studimeve të Shkrimeve të Shenjta (KSSS) detyrën e reflektimit mbi një numër total prej tri rezolutave nga Asambleja e Përgjithshme nga viti 2009, dhe duke bërë rekomandimet e duhura për veprim nga Asambleja e Përgjithshme e vitit 2013. Raporti në vazhdim fillon me reagimin e Komisionit për rezolutën JUD-805 në lidhje me Nenin IV (Shkrimet e Shenjta) të Neneve të Besimit. Kjo është ndjek nga reagimi i komisionit ndaj Rezolutës JUD-802 dhe Rezolutës JUD-816 të dyja duke iu referuar Nenit VI. Shlyerja, nga Nenet e Besimit. Raporti arrin kulmin me një rezolutë nga Komisioni i Shkrimeve të Shenjta në lidhje me referimin e rezolutave të ardhmshme duke iu adresuar Neneve të Besimit.

I. PËRGJIGJE REZOLUTËS SË KUVENDIT TË PËRGJITHSHËM JUD-805 TË VITIT 2009, NË LIDHJE ME NENIN IV (SHKRIMET E SHENJTA)

Rezoluta JUD-805: në lidhje me Nenin IV. Shkrimet e Shenjta; për të hequr shprehjen “zbulimi i pagabueshëm i vullnetit të Perëndisë në lidhje me ne në të gjitha gjërat e nevojshme për shpëtimin tonë,” dhe ta zëvendësojmë atë me shprehjen, “i pagabueshëm çdokund, dhe autoritetin suprem mbi gjithçka Shkrimet e Shenjta na mësojnë.”

REKOMANDIMI

Refuzo Rezolutën JUD-805 e cila kërkon ta ndryshoj formulimin e Nenit IV. Shkrimet e Shenjta. Ky komision rekomandon ta lëmë këtë Nen të Besimit siç është aktualisht.

BAZAT (PËRSIATJE)

Propozimet e Asambles së Përgjithshme të vitit 2009 për të ndryshuar Nenin IV të Neneve të Besimit Nazaretas në mënyrë që të mbrojmë pagabueshmërinë e plotë të Shkrimeve të

Shenjta qartë vjen nga brenga që Bibles të i jepet vendi që i takon në jetën dhe teologjinë tonë. Pasi që më është kërkuar t'i vlerësoj këto propozime, komisioni fillon duke shprehur vlerësimin tonë për këtë brengë dhe dëshiron ta bëjë të qartë solidaritetin tonë me të gjithë ata që kanë një pikpamje të lartë të vendit që Bibla ka në jetën e Kishës dhe të secilit të Krishter. John Wesley e deklaroi veten të jet *homo unius libri*, 'njeri i një libri,' dhe i përshkroi Metodistët si të 'Krishter-Biblik' të vendosur të predikojnë 'Krishterimin e vjetër e të thjesht-Biblik.'¹ Kështu që ne u bashkohemi të gjithë atyre që e mbrojnë dhe e mirëmbajnë autoritetin e Biblës për besimin e Krishter dhe praktikimin, doktrinën dhe etikën. Neni IV, si të gjithë nenet tjera është një nen besimi kështu që është pjesë e besimit tonë. Nën dritën e kësaj, dhe në këtë frymë, ne e ofrojmë këtë raport.

1. FUQIA E NENIT IV

Ne dëshirojmë të fillojmë duke tërhequr vëmendjen tek fuqia e Nenit të tashëm IV si një deklaratë e përkushtimit tonë ndaj autoritetit të Biblës.

(a) Absolute, frymëzim hyjnor

Së pari, neni qartë e deklaroi frymëzimin e Shkrimeve të Shenjta si 'hyjnore' dhe 'absolute': e cila do të thotë se e gjithë Bibla është e frymëzuar dhe që është frymëzuar, jo vetëm në atë kuptimin që një vepër arti thuhet se është 'frymëzuar', por nga Zoti. Të thuhet se Bibla *si e plotë* është frymëzuar është si të thuhet se ne nuk mundemi ta nxjerrim tekstin nga konteksti dhe t'i citojmë ato në mënyrë arbitrare si 'fjala e Zotit.' Ne duhet ta kuptojmë teologjinë biblike si një të tërë. E as nuk besojmë që frymëzimi hyjnor e anulon autorsinë njerzore. Secili libër ka një stil të veçantë, fjalor dhe dialekt duke reflektuar dallimin e madh të autorëve njerzor dhe kontekstin, të Jeremias dhe Ezekielit, Llukës, Palit apo madje edhe shkrimtarëve të panjohur. Ne nuk besojmë në një ide të frymëzimit mekanik në të cilat mendjet e tyre u shuan dhe ata u bënë thjeshtë marioneta.

Më tepër fuqitë e tyre mendore ishin ngritur dhe vullneti i tyre i lirë u drejtua nga Fryma e ndjeshme dhe delicate e Zotit. Pa marrë parasysh nëse ata ishin duke mbledh informata të shkruajn një tregim, ose duke e redaktuar atë që ishte shkruar me herët, apo po i shkruanin fjalimet të frymëzuara direkt nga Fryma e Shenjt, rezultati ishte një mbledhje e dokumenteve që ju përshtatën zbulimit të vullnetit dhe rrugës së Perëndisë, veprave të Zotit dhe së fundi zbulimit të Zotit në mishërimin e Birit të Tij. Prandaj ne pajtohemi me Përkushtimin e Cape Town të Kongresit të Tretë të Lozanës kur ata thonë në rrëfimin e tyre të besimit:

¹ Parathënie tek Sermons, Works [BE], Vol. 1, faqe 105; dhe 'Short History of Methodism,' Works [BE], Vol. 9, faqe 369.

Ne e pranojmë tërë Biblën si Fjala e Zotit, e frymëzuar nga Fryma e Zotit, e folur dhe e shkruar nga autor njerzor. Ne e paraqesim atë si autoriteti suprem dhe i vetëm, duke drejtuar besimin dhe sjelljen tonë. Ne dëshmojmë për fuqinë e Fjasës së Zotit të përmbush qëllimin e tij të shpëtimit. Ne e pohojmë se e gjithë Bibla është fjala përfundimtare e shkruar e Zotit, nuk do të tejkalohet nga ndonjë zbuluesë e mëtejshme, por edhe mburremi se Fryma e Shenjtë i ndriçon mendjet e njerëzve të Zotit kështu që Bibla vazhdon të flet të vërtetën e Zotit në mënyra të reja njerëzve të çdo culture.²

Ne e mbështesim fuqimisht këtë theksim të Dedikimit të Cape Town që e duam Fjalën e Perëndisë sepse ne e duam Perëndinë, e duam fjalën e tij, ungjillin e tij, i duam njerëzit e Perëndisë dhe e duam misionin e Perëndisë.

(b) Duke zbuluar vullnetin e përsosur të Zotit

Së dyti, Neni IV qart deklaron se Shkrimet e Shenjta e zbulojnë vullnetin e Zotit të përsosur. Kjo do të thotë se ajo çfarë Shkrimet e Shenjta na tregojnë për Zotin dhe veprat e tij të shpëtimit dhe qëllimin e tij nuk mund t'i anashkalojmë nga ndonjë filozofi e thjeshtë njerzore, metafizik apo etikë. Arsyet dhe kultura njerëzore janë të gjitha të rëna dhe prandaj dyshoni kur vjen puna për të dalluar vullnetin e Perëndisë, por secili nga ne mund t'i besojmë fjalës së Zotit që na është dhënë në Shkrimet e Shenjta si 'një llambë në këmben time dhe një dritë në shtegun tim' (Psalmi 119:105). Arsyja dhe përvoja njerzore mund të na drejtoj në shumë gjëra, por kur vie tek gjërat e Zotit (të cilat i japin formë gjithë jetës), ata duhet t'i përkulen asaj çka ai ka zbulu për ne në Shkrimet e frymëzuara. Ky besim është zakonisht i njohur si 'pagabueshmëria' e Shkrimeve, se është 'që në mënyrë të përsosur zbulon vullnetin e Perëndisë në të gjitha gjërat e nevojshme për shpëtim' si të dallueshme nga 'përsosmëria' absolute në çdo detaj faktik. Kjo nënkupton që, gjersa Shpirti i Shenjtë na drejton neve derisa ne dëgjojmë për zërin e Zotit që na flet përmes Shkrimeve, asnjë deklaram për zbulime private të së vërtetës së Zotit të cilat i janë shtuar Shkrimeve nuk janë të pranueshme.

Kjo sidoqoft nuk e përfshinë që ne jemi të pagabueshëm në interpretimet tona të Biblës. Disa të Krishter mendojnë se ata thjesht po e deklarojnë atë çfarë thotë Bibla, por kjo është naïve. Pa marrë parasysh nëse neve na pëlqen apo jo, çdo i Krishter është aktualisht i angazhuar në interpretimin e Biblës. Prandaj, ne duhet ta interpretojmë secilën fjalë në fjalinë e saj, secilën fjali në paragrafin e saj, secilin paragraph në kuadër të argumentit të librit si tërësi dhe secili libër biblik në kuadër të Shkrimeve si tërësi. Ne e interpretojmë Testamentin e Ri kundër sfondit të Testamentit të Vjetër, dhe Testamentit të Vjetër në dritën e Testamentit të Ri dhe veçanërisht gjersa zbuluesi e vazhdueshme na drejton tek

² Dedikimi i Cape Town: Rrëfimi i Besimit dhe një Thirrje për Veprim (Lëvizja e Lozanës, 2011).

zbulesa përfundimtare e Zotit në Jezus Krishtin. Ne ndjekim udhëzimin e besimeve të lashta të Kishës gjersa i interpretojmë Shkrimet së bashku. E gjithë kjo na thërret jo vetëm për studim të kujdeshëm, por gjithashtu për varësi në Frymën e Shenjtë. Ne presim që të gjithë predikuesit dhe mësuesit veçanërisht të angazhohen në interpretimin e Shkrimeve të dhëna në besimet e lashta dhe në Nenet e Besimit, por në çështjet tjera ne i japim liri të interpretimeve duke e siguruar që është në frymën e besnikërisë ndaj Kishës. Gjersa ne interpretojmë Shkrimet së bashku Brenda shoqërisë së Kishës, ne shikojmë tek Fryma e Shenjtë të na drejtoj në të ardhmen tek 'vullneti i Zotit, në atë që është e mirë dhe e pranueshme dhe e përsosur' (Romakët 12:2).

(c) Të gjitha gjërat e nevojshme për shpëtimin tonë

Së treti, kjo na sjell ne tek pika që Neni IV e bën të qartë qëllimin e shkrimeve të Shenjta: që e zbulojnë vullnetin e Zotit "...në të gjitha gjërat e nevojshme për shpëtimin tonë..." John Wesley ishte shumë i qartë që qëllimi i të qenurit person 'i një libri' ishte që të gjente 'rrugën për në parajsë.' Bible nuk duhet të trajtohet si një almanak ose libër magjik apo si një libër historie apo shkence. E vërteta e saj është shprehur në format e mendimit të botës së lashtë, në kulturën, kontekstin, gjeografin, kozmologjinë dhe gjuhën e tyre. Por në anën tjetër, veprat e Zotit në historinë e Izraelit dhe perfundimisht në jetën, vdekjen dhe ringjalljen të Zotit Jezus Krisht ishte 'e domosdoshme për shpëtimin tonë.' Prandaj, është pjesë e besimit tonë që Bibla është llogaria e dhënë nga Zoti për veprimet e Zotit në historinë në kohë-hapsirë dhe për këtë arsye një pjesë integrale e zbulimit të Zotit në histori dhe veçanërisht në Zotin Jezus Krisht. Dhe derisa shkenca përparon në studimin e 'librit të natyrës' në vend të studimeve biblike, megjithatë shkenca moderne është ngrit në kulturën e Krishter në bazë të bindjeve të Krishtera, dhe përfundimisht ne besojmë se gjithçka që ne dijmë përmes shkencës do ta shohim se do të jetë me shumë se në përputhje me gjithçka që na është zbuluar përmes Shkrimeve të Shenjta.

Besimi në fjalën e ungjillit të shpëtimit gjithashtu përfshinë bindjen ndaj ligjit të Zotit. Të jetosh duke e shkëlur me qëllim ligjin e Zotit siç është interpretuar nga Jezusi dhe apostujt si mohimi antinomian (nga greqishtja anti-kundër nomian-ligji) i besimit. Etika e Krishter është formuluar ashtu siç Kisha i interpreton Shkrimet e Shenjta të udhëhequr nga Fryma e Shenjtë dhe duke e marrë parasysh urtësinë e Kishës përgjatë shekujve.

(d) Çka nuk është nga Shkrimet e Shenjta nuk mund të jetë doktrinë e Kishës

Së katërti, komponimi i klauzolës finale të Nenit IV është ndoshta më i forti nga të gjithë. Formulimi i saj buron nga (Njëzet e pesë Nenet e Wesley-it) nga Neni VI i Tridhjetë e pesë Nenet e Kishës së Anglisë:

Shkrimet e Shenjta përmbajnë të gjitha gjërat e nevojshme për shpëtim; kështuqë çfardo që nuk lexohet aty, në këtë mënyrë nuk mund të provohet, nbesimi, uk do t'i kërkohet asnjë njeriu [sic], që duhet të besohet si një nen i besimit, ose të mendohet si nevojë e domosdoshme për shpëtim.

Kjo pohon një nga parimet kardinale të Reformimit, vetëm shkrimet (sola scriptura), që Shkrimet e Shenjta janë i vetmi burim i doktrinës së Krishter. Thuhet se vetëm ajo çfarë lexohet në Shkrime ose provohet nga Shkrimet mund të kërkohet të jetë si një nen i besimit ose që është i domosdoshëm për shpëtim. Natyrisht, ne si Wesleyans e dijmë (siç e dijnë edhe traditat tjera kryesore tënjë Kishe) që Shkrimet duhet të interpretohen. Ne i interpretojmë Shkrimet, të udhehequr nga traditat e Kishës, nën dritën e përvojës sonë si populli i Zotit, dhe duke përdorur arsyen e shenjtëruar. Por duke u bazuar në këtë fjalë asnjëra nga këto nuk mund të jenë në vetvete burimi apo bazat për doktrinën e Krishter, dhe gjersa ne shikojmë Nenet tjera të Besimit Nazaretas, ne e shohim që kjo në fakt është e vërtet. Ato të gjitha janë nxjerr nga Shkrimet. Traditat e Krishtera na ndihmojnë neve sot të interpretojmë Shkrimet, dhe arsyet e përvojat njerëzore janë të përfshira në këtë interpretim, dhe në artikullimin e doktrinave tona. Arsyeja dhe përvoja i kanë dhënë formë mënyrës se si janë formuar këto Nene të Besimit dhe ato ende e formojnë mënyrën se si ne i shprehim doktrinën tona dhe ato munden madje edhe të i vërtetojnë ato. Por çdo doktrinë që ne e shprehim së bashku si një besim në Nenet tona të Besimit është në të vërtet e bazuar dhe e nxjerr nga Shkrimet e Shenjta.

Pranda e tillë është edhe fuqia e Nenet IV, pra si komision ne besojmë se kur të kuptohet plotësisht, është një mburojë e mirë dhe e mjaftueshme kundër çdo teologjie që shmanget nga Shkrimet e Shenjta. Fuqia e saj dhe qartësia duhet të kuptohet dhe vlerësohet nga të gjithë ata që predikojnë në katedrat Nazaretase dhe japin mësim kolegjet apo universitetet Nazaretase. Prandaj komisioni beson që nuk është vetëm e panevojshme, por edhe që do të ishte e pavërtet ndaj traditës Wesleyan-e, në mospërputhje me teologjinë Wesleyan-e, dhe e pajustificuar nga vet Shkrimet, duke i shtuar çfardo pohimi se Shkrimet janë të 'pagabueshme plotësisht' e jo vetëm në zbulimin e vullnetit të Zotit për shpëtimin tonë, por në përcaktimin e së vërtetës në çdo deklarat çfarëdo qoftë ajo. Ajo do të ishte sikur ta kthejmë Biblën nga fjala shpëtuese e Zotit në një almanak ose enciklopedi. Të themi se Shkrimet janë "autoriteti suprem në çdo gjë që Shkrimet na mësojnë" thjesht ngre pyetjen se çka saktësisht Shkrimet na mësojnë, dhe ka konteste të shumta të pazgjidhura ndërmejt të Krishterve (madje edhe ndërmjet Nazaretasve) për këtë. Të pohojmë saktësi të plotë detajuese faktike fljalëpërfjalë të çdo pjese të Shkrimeve ("e gjitha e pagabueshme") sjell më shumë

problem sesa që zgjidh, dhe i ndan njerëzit me konteste të panevojshme, hutuese dhe të kota.

Për të mbështetur këtë përfundim, ne duhet të zgjerohemi në këtë paragraph kyq. Ne duhet ta kuptojmë se nga vjen kjo kërkesa për “pagabueshmëri” të plotë detajuese, pse është e panevojshme dhe çorientuese, dhe çfarë ka qenë pikëveshtrimi i teologëve Nazaretas.

2. Origjina Calviniste e pohimit mbi pagabueshmërinë detajuese

Debati mbi “pagabueshmërinë” ka qenë veçanërisht i fortë në Amerikën Veriore përgjatë disa dekadave të fundit, u ndez më 1974 nga libri i shruar nga Harold Lindsell, Beteja për Biblën (The Battle for the Bible), dhe në shikim të parë mund të duket që pohimi i këtij lloji të pagabueshmërisë është i rekomandueshëm. Megjithatë, është e domosdoshme të kuptojmë se ky pohim i pagabueshmërisë së plotë të Shkrimeve në çdo detaj (“pagabueshmëri e plotë”) vjen nga një traditë e veçant kalviniste. Është pjesë e një metode teologjike të veçant kalviniste, dhe nuk mund të kuptohet përveç në vendin e saj në racionalizim i cili shumë shpesh e karakterizon këtë teologji. Teologët kalvinist që dhanë mesim në Princeton në shekullin e nëntëmbëdhjet dhe fillimin e shekullit njëzet, Charles Hodge (1797-1878) dhe B.B Warfield (1851-1921) si teolog zvicerran-italian, Francis Turretin (1623-1687), dhe vie drejtpërdrejt nga çështjet e tyre kalviniste. Në betejën e tyre me Katolikët Romak, teologët kalvinist të atij shekulli pas John Calvin u mbajtën tek autoriteti i Biblës në mënyrë që të kundërshtojnë autoritetin e papës dhe të kardinalëve. Strategjia e tyre mbrojtëse i nxiti ata ta mbrojnë autoritetin e Biblës si bazë për besimin në Krishtin më tepër sesa si diçka e cila ishte nënkuptuar nga besimi në Krishtin. Metoda e tyre bëri që së pari të vendos të vërtetën dhe autoritetin e Biblës, dhe pastaj të ndërtoj besimin në Krishtin mbi atë. Bindjet intelektuale dhe apologjetikët megjithatë erdhën të parët. Disa Luteranë u larguan nga Martn Luteri duke marrë një qëndrim të tillë. Prandaj shumë nga Rrëfimet Reformuese në periudhën e pas-Reformës filuan me Nenet e Besimit në Bibël. Ishte në këtë kontekst që ata filluan të mbrojnë pagabueshmërinë e Biblës. Në përputhje me metodën e tyre deductive në teologji, ata argumentuan se pasiqë Zoti ishte i përsosur, dhe pasiqë Bibla vinte nga Ai, Bibla duhet të jet e “përsosur” në kuptimin e të qenit pa asnjë gabim në detajet më të vogla. Ishte më tepër një supozim që ata e sollën për Biblën sesa një rezultat nga vetë studimi i tekstit biblik. Jo të gjithë kalvinistët e morën këtë qëndrim. Traditat kalviniste Holandeze dhe Skoceze (Hermann Bavinck, Abraham Kuyper dhe James Orr) janë të ndryshme dhe më të përafërta me John Calvin dhe Reformatorët. Këmbëngulja në pagabueshmëri ishte veçanërisht e fuqishme

ndërmjet Calvinistëve Amerikan, ndoshta na ndihmon të sçarojmë pse Fundamentalizmi është fenomen kryesisht Amerikan.

Vetë Reformatorët continental, John Calvin, Martin Luther, Ulrich Zwingli dhe të tjerë, nuk bënë ndonjë deklaratë të tillë, dhe asnjë deklaratë e tillë nuk është bërë në Nenin VI të Njështes e nëntë Neneve të Kishës së Anglisë. Kjo ishte një deklaratë e re në periudhën pas Reformimit. Për vetë Reformatorët, ishte besimi në Krishtin që i drejtoi tek besimi në Bibël. Martin Luteri i pari shpalli shfajsim nga besimi (sola fide) dhe vetëm atëher kur papa e kundërshtoi këtë ai e pa nevojën që Kisha të i nënshtrohet Biblës (sola scriptura). Për këta teolog të mëvonshëm të traditës Calviniste, besimi në pagabueshmërinë e Biblës u bë themeli për besimin në Krishtin. Ishte nga kjo traditë Calviniste, që kaloi tek teologët Calvinist përgjatë shekullit nëntëmbëdhjetë në Princeton, që Fundamentalistët e viteve 1920-ta e morën besimit e tyre të plotë, pagabueshmëri e Shkrimeve në detaje. Harold Lindsell provoi t'i mbante të gjithë të Krishterët ungjillor në këtë besim specific Calvinist në vitet 1970-ta dhe seriozisht e ndau Krishterimin ungjillor, së paku në Shtetet e Bashkuara nëse jo diku tjetër. I gjithë ky zhvillim me brengat e tyre të fakteve të pagabueshmërisë në detaje, na tregon se sa shumë tradita Calviniste është formuar nga moderniteti racionalist.

Wesleyan-ët janë Reformatorët e vërtetë. Ne e dimë që ne nuk jemi sjell në besim duke e pas pagabueshmërinë e Biblës të provuar, por që besimi ynë në Krishtin na drejton neve t'i besojm lajmëtarët e tij, profetët dhe apostujt, dhe të gjithë ata që i shkruan Shkrimet e Shenjta. Nuk është që ne s'jemi të përkushtuar si denominacion për pikpamjet e kundërta se Shkrimet të dyshimta ose se ato janë historikisht të pasigurta. Jo: ne jemi të përkushtuar tek besimi që Shkrimet na japin një llogari të mjaftueshme për veprimet e Zotit në historinë e Izraelit e veçanërisht në lindjen, jetën, vdekjen dhe ringjalljen më trup të Zotit. Më tepër është se ne nuk mendojmë që duke e theksuar çështjen e pagabueshmërisë faktike detajuese është ndihmuese ose e domosdoshme të insistojmë në autoritetin e plotë dhe besueshmërinë në Shkrimet e Shenjta. Neni VI i Tridhjetë e nëntë Neneve të Kishës të Anglisë prandaj është titulluar, " nga Qëndrueshmëria e Shkrimeve të Shenjta" gjithashtu paraqitet në titullin e Nenit të Pestë të Njështes e pesë Neneve të John Wesley që iu dhanë Metodistëve Amerikan.³

³ Për rëndësinë e këtij koncepti të "mjaftueshmërinë" për shpëtim, shiko Paul Merritt Bassett, "The Theological Identity of the North American Holiness Movement: Its Understanding of the Nature and Role of the Bible," Varieties of American Evangelicalism (Knoxville, TN, 1991), faqet 72-108, veçanërisht faqet 76-79.

3. PSE KY BESIM KALVINIST ËSHTË MËNYRA E GABUESHME TË MBROJMË AUTORITETIN E SHKRIMEVE

Ka dy mangësi të rënda në pohimin e autoritetit të Shkrimeve duke deklaruar pagabueshmërinë e detajuar faktike të Shkrimeve në vend se të “mjaftueshmërisë” së tij. Së pari, koncepti i “gabimit” nuk është ndihmues psikë është e pamundur të definojmë çka përmban një “gabim”. Fjala duket se perfshinë nevojën për saktësi absolute, por çfarë shkalle e saktësisë është e përshtatshme? A këmbngulim ne në atë lloj të gjuhës së saktësisë moderne shkencore e cila është e panjohur në të gjithë literature e lashtë? A janë të pranueshmu shifrat e përafërta? A duhet çdo tregim të zbatoj kronologji të saktësisë së rrept? A janë metaforat dhe shëmbëlltyrat të palejueshme? A duhet që ne të këmbngulim që tregimet e thëna nga Jezusi duhet të jenë faktikisht të sakta? Madje edhe nëse ne e pranojmë se Shkrimet janë plot me metafora dhe shëmbëlltyra dhe tjera figura të shprehjes, a duhet ne të urdhërojmë deri ku secili duhet vendos kufirin-çfarë është fakt i saktë dhe çfarë është metaphor dhe shëmbëlltyrë, poezi dhe vision? Koncepti i “gabimit” është një fjalë absolute që i aplikohet diçkaje e cila është domosdoshmërisht një çështje e shkallës, dhe si pasojë është një makth pasiqë na drejton neve direkt në pyetje sinçerisht të pakuptimta dhe të kota. Kjo është pika e dytë këtu: ky concept i devijuar i “pagabueshmërisë” detajuese shmang vëmendjen në debate jo përfituese për detaje të parëndësishme. Ishte Abiathari ose Abimeleki që ishte prift i lartë kur Davidi hëngri bukën e shenjtëruar? Ishin dy engjij tek varri, ose ishte vetëm një? A e vari veten Juda apo vdiq në ndonjë tjetër mënyrë? Ka debate të panumërta në pikat të cilat nuk kanë ndikim në të vërtetën e ungjillit dhe të cilat janë humbje kohe. Për shkak se ne kemi të bëjmë me literaturë antike, ne shpesh nuk kemi mjaft informata të vendosim nëse një kontraditë e dukshme është një kontraditë e vërtet apo jo. Të pohojmë pagabueshmërinë e plotë prandaj duhet të shmangim argumentet e vogla dhe të padobishme sikur ato në Efes që debatuan “mitet dhe gjenalogjinë që nxisin spekulime të kota” dhe kishin “humbur në diskutime të kota” (1 Timoteut 1:4-6).

Ajo që na bind neve për të vërtetën e Shkrimeve është se kur predikohet në fuqinë e Frymës ne vijmë ballë për ballë me Zotin. Ne jo vetëm që e dijme “se Ai vdiq për mëkatet tona duke u bazuar në Shkrime, që ai ishte varrosur, që ishte ringjallur në ditën e tretë sipas Shkrimeve, që ai iu shfaq Kefës, pastaj të dymbëdhjetve” (1 Korintasve 15:3-5). Pali na i jep këto si fakte krejsore të ungjillit, dhe ne besojmë që ska arsye të mirë për të dyshuar vërtetësinë e tyre historike. Por nuk është thjesht një çështje e të dhënimit të fakteve të sakta. Më

tepër është se përmes këtij tregimi, ne vijm për të takuar e njohur e të besojmë dhe të vendosim besimin tonë në vetë Zotin e Ringjallur. Kjo është mënyra si tregimi e bart bindjen e ungjillit kur ne ungjillizojmë- jo duke e bindur kërkuesin se ne mund të caktojm me saktësi se sa engjuj ishin tek varri. Autoriteti i Shkrimeve është vërtetuar nga Shpirti i Shenjtë gjersa ne e tregojmë “tregimin shumë, shumë të vjetër.” Ne i respektojmë vëllezrit dhe motrat tona që i duan Shkrimet dhe duan ta mbrojnë autoritetin e tyre, por si Wesley-an është bindja jonë që të provosh të bësh kështu në këtë mënyrë Calviniste është mënyra e gabuar për ta bërë.

4.PIKËVËSHTRIMI I PËRBASHKËT I TEOLOGËVE NAZARETAS

Është e vërtet se në kulmin e betejës Fundamentaliste-Moderniste në vitet e 1920-ta, udhëheqësit Nazaretas e shprehen solidaritetin e tyre me Fundamentalistët. Duke dhënë alternativën, në teologjinë Moderniste/Liberale në të cilën (siç e ka vendos H. Richard Niebuhr), “Një Zot pa zemrim e solli njeriun pa mëkat në një mbretëri pa gjykim përmes shërbesës së Krishtit pa kryq,” kjo nuk është për tu befasuar! Por teologët e denominacioneve kryesore, H. Orton Wiley, kishin një kuptim më të thellë të këtyre çështjeve.⁴ Wesley-anët ishin të përkushtuar të pohojnë autoritetin e Biblës kundër Modernizmit, por jo në mënyrën më të thjeshtë në të cilën Fundamentalistët provuan ta bënin. Paul M. Bassett shkruan që, duke e ndjekur tadtën e teologëve Wesleyan, Richard Watson, W. B. Pope dhe John Miley, “Wiley çartë futet në listën kundër teologëve liberal Amerikan në njërin anë dhe kundër fundamentalistëve në anën tjetër.”⁵ Në Teologjinë e tij të Krishter, ai i kritikon shkollarët Protestant në shekullin pas Reformimit në të cilin ata filluan “të zëvendësojnë fjalën e shkruar me Fjalën e Gjallë Krishtin.” Në atë kontekst në të cilin ai ishte duke shkruar, është e çartë (siç e dëshmon Paul Bassett) që H. Orton Wiley ishte gjithashtu duke i kritikuar Fundamentalistët e ditëve të tij të cilët e kishin trashëguar pikëvështrimin e tyre të pagabueshmërisë detajues të Biblës nga shkollarët Calvinist.⁶ Ai shkon aq larg saqë i bën tre paralajmërime kundër “monarkëve të denjë” për të cilët ne gabimisht mund të japim një pozitë false në vendin e Krishtit, në Fjalën e Gjallë: Kishën, Biblën dhe arsyen. Ka një arsye të mirë të vijmë në përfundim që ishte H.

⁴ Për shkak se mënyra në të cilën brengat Fundamentaliste pushtuan lëvizjen për shenjtërim dhe Kishën e Nazaretit për një kohë, shiko Paul Merritt Bassett, *The Fundamentalist Leavening of the Holiness Movement, 1914-1940: The Church of the Nazarene: A Case Study,* Wesleyan Theological Journal (WTJ) 13:1 (1978), faqet 65-91; dhe Stan Ingersol, *Strange Bedfellows: The Nazarenes and Fundamentalism,* WTJ 40:2 (2005), faqet 123-141.

⁵ Bassett, “Theological Identity,” cf.91

⁶ Bassett, “Theological Identity,” 91-94, duke iu referuar Wiley, *Christian Theology*, faqet 1:140-142.

Orton Wiley i cili e hartoi Nenin IV në Asamblen e Përgjithshme të vitit 1928, e cila është një arsye e mirë në vetvete se pse Neni IV nuk duhet të ndryshohet.

Timothy L. Smith, në një letër drejtuar redaktorit të Christianity Today të publikuar më 10 Mars, 1978 njejt pohon që Wesley-anët i kundërshtuan të dy qëndrimet “liberalistët” ose “modernistët” dhe gjithashtu e ngushton pikëpamjen e përsosmërisë së Shkrimeve në lidhje me B. B. Warfield dhe Harold Lindsell. Timothy Smith shkroi: “... ne Wesley-anët qëndrojmë në një traditë ungjillore më të vjetër dhe shumë më të gjerë sesa ajo e prezentuar nga noe-Kalvinistët skolastik”. Në një letër drejtuar redaktorit të Christian Centruy, ai pohoi se se “rrënjët e pikëvështrimit neofundamentalist të autoritetit të shkrimeve i pranuar nga shumë ungjillorë” i vendosur në shkrimet e Reformatorëve, dhe që pikapamja e Hodge-Warfield e pagabueshmërsisë kurrë nuk ishte mbajtur nga udhëheqësit ungjillor të tillë si William Booth, Adoniram J. Gordon, Dwight L. Moody, ose nga liderët e Asosacionit Kombëtar të Shenjtërisë. Ai i hodhi poshtë përpjekjet bashkohore të pagabueshmërisë, Harold Lindsell dhe Francis Schaeffer, “të vendosin mbi ungjillorët modern një pikëpamje të Shkrimeve të cilën Jezusi dhe Pali e refuzuan në Judaizmin rabinik.”⁷

Në mënyrë të ngjashme, Ralph Earle citon teologun e hershëm Nazaretas A. M. Hills, që Bibla është e pagabueshme në atë që na tregon neve për Zotin dhe shpëtimin, jo në pagabueshmërinë e detajeve:

Cila është ajo pagabueshmëria që ne e deklarojmë për Biblën? A është e pagabueshme duke iu referuar qëllimit për të cilin ishte shkruar. A është e pagabueshme si një zbuluesë e dashurisë shpëtuese të Zotit në Krishtin në një botë të ligë. Pagabueshmëria e saj i drejton të gjithë shpirtat e sinçert dhe të gatshëm e kërkues tek Krishti, tek shenjtëria, tek parajsja.⁸

Ralph Earle pastaj vazhdon duke e mbrojtur një koleg dijetar ungjillor i cili e kishte pranuar se ka gabime në Bibël në retorikë, histori dhe shkencë. Në të njëjtën kohë ai mendon se kolegu i tij kishte bërë më shumë lëshime nga sa kishte nevojë dhe e kishte pranuar që aty kishte fakte kontradiktore ku të dhënat historike mund të harmonizohen nga hemeneutika e kujdesshme.⁹

J. Kenneth Grider njejt e kundërshtoi pagabueshmërinë detajues. Ai merr parasysh një fjali nga Wesley e cituar nga Harold Lindsell e cila duket se mëson pagabueshmërinë detajuese, por argumenton se kur ajo fjali merret nga konteksti i teologjisë së përgjithshme të Wesley-it, ai nuk e mësoi pagabueshmërinë si

⁷ Timothy L. Smith, “Reader’s Response: Determining Biblical Authority’s Base,” *The Christian Century* 95 (March 2, 1977): faqe 198.

⁸ A.M. Hills, *Fundamental Christian Theology*, Pasadena: C.J. Kline, 1931, faqe I:134.

⁹ Ralph Earle, “Further Thoughts on Biblical Inspiration,” *Journal of the Evangelical Theological Society*, Vol. 6, No. 1 (Winter 1963): faqe 7-17, (sidomos faqe 15).

pjesë e metodës së tij në mënyrën e shkollarve Calvinist. J. Kenneth Grider argumenton se: "... vetë Shkrimet nuk janë të interesuara në pagabueshmërinë. e bën një deklaratë për inspirim, por jo për pagabueshmëri-së paku, jo për pagabueshmëri të plotë."

J. Kenneth Grider shqyrton atë kërkesën për inspirim tek 2 Timoteut 3:16, dhe thekson që duke u bazu në tekst është inspirim specific për mësim (të doktrinës) dhe praktikës¹⁰.

Rob L. Staples e kundërshton Wesleyan-izmin me Fundamentalizmin, i cili u ngrit në tokë Calviniste dhe insiston në "pagabueshmërinë epistemologjike (teori e njohurisë)." Wesleyan-izmi punon ndryshe dhe e mban një pikëpamje që e quan "pagabueshmëri soteriologjike (doktrina e shpëtimit)"¹¹. Në një artikull tjetër, ai fillon me thënien e Martin Luther: "Bibla është grazhdi në të cilin është vendos Jezusi." Rob Staples komenton:

Pika e analogjisë së Martin Luther është që Krishti, i cili është Fjala e Gjallë, duhet të gjendet në Bibël, e cila është Fjala e Shkruar. Por kjo e fundit është një instrument që na drejton neve tek e mëparshmeja, dhe nuk është një fund në vete¹².

Paul M. Bassett argumenton në një artikull në të kuptuarit e Biblës në lëvizjen e shenjtërisë, që historia e saj dhe logjika e saj e brendshme e drejton atë në prfundimin, "që një thirrje si e Lindsell-it [për pagabueshmëri në detaje] është teologjikisht dhe frymërisht e parëndësishme." Paul Bassett vazhdon:

Historia e saj dhe logjika e brendshme do ta drejtonte atë në përfundimin se, nëse termi pagabueshmëri përdoret, siç është, i referohet shërbimit të Biblës si një krijim unik i Frymës së Shenjtë, e menduar nga po ajo Frymë të sjellë bindjen për mëkat, lajmin për shpëtim të plotë në Krishtin, dhe udhëzime të sakta se si të lidhemi me Zotin dhe të afërmin në drejtësi dhe shenjtëri të vërtet. Në këto gjëra Bibla duhet të kuptohet si plotësisht e pagabueshme.

Paul Bassett vazhdon të përjashtojë pagabueshmërinë më të detajuar ("pagabueshmërinë e plotë"):

Lëvizja ka ardh në përfundim se, pasi që saktësia empirike ose shkencore me siguri nuk është soteriologjia përfundimtare madje nuk është as metafizikisht përfundimtare, ato duhet të llogariten si terme të diçkaje tjetër veçmas vetë saktësisë shkencore.... Shumica e njerzve të shenjtërisë do të këmbngulin se pyetje të tilla duhet t'i drejtohen pyetjes të qëllimit përfundimtar të vetë

¹⁰ J. Kenneth Grider, 'Wesleyanism and the Inerrancy Issue, WTJ 19:2 (1984), faqet 52-61.

¹¹ Rob L. Staples, 'Inerrancy,' Holiness Today, June 1998, faqe 5.

¹² Rob L. Staples, 'Scripture,' Holiness Today, December 1998, faqe 11.

Shkrimeve, e cila nuk është njohuri absolute e përpiktë e të gjitha gjërave në qiell dhe tokë por mjaftueshmëri soteriologjike (doktrina e shpëtimit)¹³.

H. Ray Dunning vë në dukje se disa ungjillorë bazohen tek autoriteti i Biblës në pagabueshmërinë e saj, por vie në përfundim se “mbrojtje të tilla racionle janë më pak se bindëse.”¹⁴ H. Ray Dunning vazhdon duke cituar A. M. Hills, Clark H. Pinnock, Richard S. Taylor, H. Orton Wiley madje edhe John Calvin të mbështet pikëpamjen alternative të autoritetit të Biblës, se ne jemi të bindur nga testimonium internum Spiritus sancti, dëshmitari i brendshëm Fryma e Shenjtë. Këtë ai e sheh si një aspekt të doktrinës së hirit paraprirës.¹⁵

Ne duhet të vijmë në përfundim se teologët Nazarenas si të tërë, me pak apo ndonjë përjashtim, janë plotësisht kundër idesë se ne duhet të pohojmë pagabueshmërinë e plotë faktike detajesu të Shkrimeve të Shenjta në mënyrë që ta mbrojnë autoritetin e saj. Si një trup, ata janë plotësisht të përkushtuar ndaj autoritetit të saj në çështjet e besimit dhe praktikimit, doktrinës dhe etikës. Pyetja se nëse Bibla është plotësisht e sakt në çdo deklaram nuk është prandaj diçka në të cilën ka nevojë shpall një mënyrë apo një tjetër në Nenet e saj zyrtare të Besimit, sepse është shumë e parëndësishme.

Dy redaktorët e Herald of Holiness e theksuan një pikë shumë të mirë se Neni i tashëm i Besimit IV është shumë i gjerë. W. E. McCumber komentoj në “The Answer Corner” që Neni IV “nuk na përjashton ne nga pro apo kundër pagabueshmërisë së plotë, dhe siç pret njeriu, ka ithtar të dy koncepteve “të frymëzimit të plotë” që gjenden në mesin tonë.” Ai vet erdhi në përfundim, “Nuk është pagabueshmëria, por se do të arrijë qëllimin e saj pa dështuar kur Fryma e Shenjtë e përdor atë t’i bind për mëkat dhe t’i tërheq tek Krishti, duke e bërë të mundur shpëtimin tonë.”¹⁶ Wesley Tracy, në “The Question Box,” e bëri të qartë këndvështrimin e tij se pikëpamja e pagabueshmërisë së plotë “ është bërë një markë fabrikuese dhe një thirrje beteje e ashpër, krahu i djathë, fundamentalistët Kalvinist” dhe se nuk përket në traditën Wesley-ane.

Megjithatë, ai komenton se Neni IV është “i gjerë”: dhe se ted y palët fundamentalistët e ashpër që besojnë në pagabueshmërinë mund të pajtohen me nenin, deris ata “që kanë një pikëpamje më pak të ashpër... gjithashtu kanë një hapsirë të mjaftueshme,”¹⁷

Kjo na sjell në një mendim përfundimtar. Që pikëpamja e pagabueshmërisë detajuese jo vetëm që bie në kundërshtim me teologjinë Wesley-ane, dhe që

¹³ Paul Merritt Bassett, ‘Theological Identity,’ 94f.

¹⁴ H. Ray Dunning, Grace, Faith, and Holiness (Kansas City: Beacon Hill, 1988), faqe 62.

¹⁵ Ibid, faqet 58-65.

¹⁶ W.E. McCumber, Herald of Holiness March 15, 1985, faqe 31.

¹⁷ Wesley Tracy, Herald of Holiness, January 1992, faqe 33.

është hedhur poshtë nga teologët drejtues Nazarenas, por nëse Neni IV do të ishte kërkuar të ndryshohet për të na kufizuar neve në atë pikapamje të veçant të Shkrimeve, gjerësia e tanishme e cila mund t'i përfshijë të dy pikapamjet do të zëvendësohej nga pikëpamja e kufizuar fundamentaliste. Pasiqë teologët Nazaretas dhe shkollarët biblik si një tërsi do të kundërshtonin fuqimisht këtë kufizim të këtij Neni të Besimit, siç do të bënin edhe shumë pastor drejtues dhe njëriëz laik, një lëvizje e tillë do të kercënonte një ndarje shumë serioze në denominacione. Kjo ndarje dhe këto kriza të rënda dhe dhimbja e parë tek denominacionet tjera na tregojnë se kjo mund të ketë rezultate shumë serioze për unitetin tonë dhe mund t'i bëjë dëme serioze Kishës së Nazaretit.

Për të gjitha këto arsye, komisioni fuqimit këshillon që këto ndryshime duhet të refuzohen. Nazaretasit janë të bindur nga Neni IV i tanishëm për mjaftueshmërinë e Shkrimeve të Shenjta, autoritetit përfundimtar të saj në të gjitha çështjet e besimit të Krishter dhe jetesës, në doktrinë dhe etikë. Kjo është gjitha që duhet të themi.

II. PËRGJIGJE PËR REZOLUTËN JUD-802 DHE REZOLUTËN JUD-816 NË LIDHJE ME NENIN VI (SHLYERJA)

PASQYRË

Në vitin 2001, 2005 dhe 2009, secila Asamble e Përgjithshme ka pranuar rezoluta në lidhje me terminologjinë e Nenit VI. Shlyerja. Në 2001, tri rezoluta erdhën nga delegatët duke kërkuar të ndryshojnë termin “i merituar” në “sakrifikues” (“...nga vdekja e tij sakrifikuese [meritore] në Kryq...”). Komisioni legjislativ i emëruar t'i studioj rezolutat i ndryshoi ato, dhe këshilloj largimin e të dy termeve (“meritor” dhe “sakrifikues”) nga deklarata. Më 2001 Asambleja e Përgjithshme dhe rajonale i miratuan ndryshimet e rezolutave; kështu, as “meritore” e as “sakrifikuese” nuk u shfaqën në deklaratën e tanishme të këtij Neni të Besimit (“...nga vdekja e tij në kryq...”). Në 2005 dhe 2009, secila Asamble e Përgjithshme pranoi vendime për ta rikthyer termin “meritor” në Nenin VI (“...nga vdekja e Tij meritore në Kryq...”). Në të dy rastet, këto vendime iu referuan Bordit të Mbikqyrësve të Përgjithshëm (BMP) për studime të mëtejshme. BMP, si kthim të përgjigjes, e ngarkoi Komisionin e Studimeve të Shkrimeve me detyrën që të reflektojnë mbi këto dy vendime të Nenit VI nga Asambleja e Përgjithshme e 2009, dhe të japin rekomandime adekuate për veprim në Asamblen e Përgjithshme të 2013.

Rezoluta JUD-802: kërkon të rivendos termin “meritore” në formulimin e Nenit të Besimit VI. Shlyerja (“nga vdekja e tij meritore në Kryq”).

Rezoluta JUD-816: kërkon të ndryshoj formulimin e Nenit të Besimit VI. Shlyerja duke përfshirë disa “referenca për dashurinë e Perëndisë si factor motivues në shlyerjen (Gjoni 3:16) dhe referenca më të gjera për aspekte tjera të shlyerjes.”

REKOMANDIMET E KOMISIONIT

Rekomandimi 1: Kundërshto Rezolutën JUD-802 e cila kërkon të vendos termin “meritore” në formulimin e Nenit të Besimit VI. Shlyerja. Ky komision rekomandon të lihet Neni i Besimit VI siç qëndron tani.

Rekomandimi 2: Kundërshto Rezolutën JUD-816 e cila kërkon të ndryshoj formulimin e Nenit të Besimit VI duke përfshirë disa “referenca ndaj dashurisë së Perëndisë si factor motivues në shlyerje (Gjoni 3:16) dhe referenca më të gjera për aspektet tjera të shlyerjes.” Komisioni rekomandon të lihet Neni i Besimit VI siç qëndron tani.

Rekomandimi 3: Komisioni rekomandon që thirrja e Asambles së Përgjithshme e vitit 2013 mbi institucione të ndryshme të Kishës së Nazaretit të mbajë dhe prodhojë studime, konferenca dhe shkrime me qëllim të shpjegimit të konceptit të shlyerjes, kështu duke pasuruar të kuptuarit e Kishës dhe besimit.

PËRSIATJE

Gamë e gjerë e Dispozitive të Shlyerjes. Bibla përdor një gamë të gjerë të imazheve për të kapur dimensionet e pafundme të vdekjes shpenguese të Krishtit në Kryq. Kjo përfshinë sakrificën, shpërblimin/shpengimin, shlyerjen, kënaqësinë, zëvendësimin, ndikimin moral dhe të tjera. Këto modele shprehin pamje të ndryshme në lidhje me rolin e zemrimit të Zotit dhe dashurisë së Zotit në lidhje me shlyerjen. Qartë, asnjëra nga këto nuk mund të shfaq mozaikun e plotë të dispozitive të dhuruara ndaj njerëzimit mëkatar përmes shlyerjes. Kështu, është e përshtatshme që Neni i Besimit VI të shmang termet të cilat i japin vëmendje disproporcionale një imazhi duke e përjashtuar apo neglizhuar të tjerët. Është me interes të mbrohet natyra gjithpërfshirëse e dashurisë shpirtmadhe të Zotit e demonstruar në Kryq dhe uniteti në Kishë që ngritet nga po i njejti hir nga i cili komisioni e bën këtë rekomandim.

Për më tepër Nenet e Besimit në vdekjen shfajsuese të Krishtin nuk mund të lexohen pa të vërtetat biblike të shprehura në Nenet tjera të Besimit në mëkatin e njerzimit, nevojën tonë për shfajsim e shenjtërim të plotë, gjykimin dhe drejtësinë e Zotit, dhe rilindjen e gjithë krijimit. Vdekja e Krishtit me bollëk i përgjigjet realitetit të njerzve dhe nevojës së krijesës për pajtim me Zotin e shenjtë dhe me njëri-tjetrin (romakët 5:15-17).

Gjuha koncize në Nenet e Besimit të Kishës. Nenet e Besimit të Kishës kërkojnë të pasqyrojnë dy çështje: 1) të transmetoj elementet kryesore të besimit për secilën doktrinë, dhe 2) të shmang terminologjinë e cila zbret ose kalon përtej nga ajo që është e përshtashme për ekspozim të një doctrine të veçant. Prandaj, Nenet e Besimit janë hartuar me kujdes, dhe janë qëllimsht koncize. Pra, ne besojmë që është e nevojshme të konfirmojmë vetëm të vërtetën kryesore të doktrinës siç është shprehur në Nenet e tanishme të Besimit.

Rivendosja e panevojshme e termit “e merituar.” Ka arsye të mira pse është e panevojshme ta rivendosim fjalën “e merituar:” 1) fjala “e merituar” nuk ishte një term i rëndësishëm në vetë predikimet e John Wesley-it në doktrinën e shlyerjes dhe nuk është prezentuar si një term i rëndësishëm në doktrinën e tij sipas dijetarëve historik kryesorë bashkohorë (Collins, Maddox, Williams), 2) fjala “e merituar” nuk është e theksuar në teologjinë e H. Orton Wiley, edhe pse koceptet e përafërta të kënaqësisë, zëvendësimit dhe shlyerjes janë, dhe 3) fjala “e merituar” nuk është në vetvete një fjalë biblike.

Mjaftueshmëria e deklaratave aktuale. Fjalët “e merituar” dhe “sakrifikuese”, edhe pse të përshtatshme, jnaë të panevojshme pasi që atë çfarë ato thonë tashmë është e përfshirë në vetë fjalën “shlyerja.” Vetë termi “shlyerje” përmban koceptin kryesor që Krishti e ofroi veten si sakrificë vetëm përmes të cilës ne jemi pajtuar me Zotin dhe kështu e merituar (ose “e fituar” ose “e siguruar” - Hebrejët 9-12) çlirim tonë përmes bindjes së tij.

PËRFUNDIMI

Më shumë studime bashkpunuese janë të nevojshme. Komisioni e pranon vlerën e diskutimeve të shëndetshme dhe studimeve të thella në lidhje me doktrinën themelore mbi shlyerjen. Sidoqoftë, një dialog i tillë duhet të shtrihet përtej aspektve të kufizuara të përzgjedhura që ta përfshijmë gamën e gjerë të kuptimit. Hetimet duhet të vazhdojnë për hir të pasurimit të rrëfimeve të Kishave tona duke e kuptuar më shumë punën e hirit të Zotit për shpëtim.

Pasi që Kisha e Nazaretit e pranon shlyerjen në tërësinë e vet, komisioni ikurajon dialog dhe studime të mëtejshme nga anëtarët e saj me mendje teologjike. Kjo thërret për një mprehtësi shkencore dhe nderues ndërmjet imazheve të shlyerjes të shprehur nga shkrimtarët biblik nën frymëzimin e Frymës, dhe teorive, shpesh të mangëta, që mendimtarët e mëvonshëm të Krishter ua bashkangjiten atyre.

Shqestësime janë shprehur se roli i Kryqit dhe shlyerja meritojnë theksim më të madh se sa shpesh pranojnë. Shpresohet se eksplorime të reja në dashurinë e Krishtit do të mbushin

Kishën me energji të madhe dhe do të shërbejnë si një katalizator që e mbledh gjithë Kishën për të plotësuar Urdhërimin e Madh.

Prandaj, komisioni ka rekomanduar që thirrja e Asambles së Përgjithshme të 2013 mbi institucionet e ndryshme të Kishave të Nazaretit të mbajnë dhe bëjnë studime, konferenca dhe shkrime me qëllim të shtjellimit të konceptit të shlyerjes, duke e pasuruar kuptimin dhe besimin e Kishës.

POHIM

Ne duam të pohojmë se doktrina domosdoshmërisht drejton në jetë praktike, ortodoksi (zbatim i bindjeve të pranuar) duhet të përkthehet në orthopraxy (praktikim i duhur). Studimi skollistik është një ndihmë për besimin dhe jetën e trupit të besimtarëve. Ne jemi të thirrur të jetojm nga ungjilli I Krishtit si pasyqrimi i pazbulueshëm i dashurisë së shenjtë të Zotit. Gjersa shkollarët i studiojnë këto të vërteta të mdha, Kisha është përgjegjëse të jetoj nga drita që ne tash e kemi. Wesley-anët gjithmonë kanë qenë njerëz me soteriologji (doktrinë e shpëtimit) praktike, në të dyat zemër dhe jetë, dhe me një bring të thellë për ungjillizim dhe shërbesa të dhembshurisë.

Gjersa flasim për vdekjen e Krishtit dhe shlyerjen, Bibla na e zbulon realitetin e hirit që pajton njerëzimin armiqsor me Perëndinë, duke na sjell paqe me Zotin, dhe kështu duke na bërë ne pjesë të krijesës së re (Efesianët 2:14-16; Kolosianët 1:19-22). Pa humbur asnjë sekond Shkrimet na e pohojnë se Krishti e rrëzoi murin që i ndante njerëzit mes vete, duke i bërë ata një, dhe kështu nxiti Kisha të jetpjmë këtë jetë dhe shërbesën e pajtimit në plotësinë e saj (Efesianët 4:1-6; 2 Korintasve 5:14-15, 17-21).

Si pasojë e kësaj ne i bëjmë thirrje kishës të ketë parasysh kërkesën e dyfishtë: të besojë se vdekja e Krishtit e pajtoi njeriun, dhe të jetojnë jetën e njerzëve që janë pajtuar përmes hirit. Paqja me Zotin dhe Atin tonë i jep formë jetës se lutjes sonë të përbashkët e cila si kthim i prek të dyja botët të dukshmen dhe të padukshmen, e fuqizon gatishmërinë tonë për të falë njëri-tjetrin, dhe e motivon mënyrën se si ne i ndajm posedimet dhe jetat tona. Gjithashtu na bën neve ambassador ungjillizues të Krishtit (Mateu 5:9) duke folur me një zë profetik.

Pajtimi me Perëndinë dhe njëri-tjetrin është gjithashtu themeli dhe motivimi për të kerkuar drejtësinë që Zoti e kërkon, pa të cilën, Zoti thotë, nuk do të ketë paqe. Pajtimi i vërtet dhe i qëndrueshëm kërkon pranimin e mëkateve të kaluara dhe të tashme, pendimin para Zotit, rrëfimin para atyre që i kemi lëndu, si dhe kërkimin dhe pranimin e faljes. Gjithashtu përfshinë dedikimin e Kishës për të kerkuar drejtësi ose riparim, kur është e përshtatshme, për ata që kanë qenë të dëmtuar nga dhuna dhe shtypja.

Mezi presim të shohim Kishën mbarëbotrore të Krishtit, ata të cilët janë pajtuar me Zotin, duke e jetuar pajtimin me njëri tjetrin dhe të dedikuar ndaj detyrës dhe vështirësisë e të bërit të paqes biblike në emër të Krishtit.¹⁸

REKOMANDIMI I KOMISIONIT DUKE KËRKUAR NJË REZOLUTË NGA ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME 2013 PËR NDRYSHIME TË MANUALIT

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME PËR NDRYSHIME TË MANUALIT

Komisioni i Studimeve të Shkrimeve (KSS) rekomandon si në vazhdim, e cila kërkon një ndryshim në Manualin e Kishës së Nazaretit, dhe është prezantuar si një rezolutë e veçant tek Asambleja e Përgjithshme 2013, përmes një komisioni legjislativ:

SHËNIM: NJË BAZË LIGJORE ËSHTË LISTUAR ME SHKRONJA TË ZEZA ANASH REKOMANDIMIT DHE I ËSHTË REFERUAR KOMISIONIT PËRKATËS.

SCC REKOMANDIMI #1

1. Nenet e Besimit (JUD-2- Komisioni Special Gjyqësor)

VENDOSI që një paragraf i ri t'i shtohet Manualit si në vazhdim:

Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me Nenet e Besimit (paragrafi 1-22) duhet t'i referohet Bordit të Mbikqyrësve të Përgjithshëm për shqyrtim nga një organ me teologë që e pasyron naturën e kishës mbarë botrore. Komisioni duhet t'i raportoj, me ndonjë rekomandim apo zgjidhje, Asamblesë së Përgjithshme pasuese.

MË TEJ VENDOSI që, nëse miratohet, ky vendim të vendoset në seksionin e Kushtetutës të *Manualit të Kishës së Nazaretit*.

ARSYET:

1. Nenet e Besimit përfshijnë pozicionet themelore të doktrinës të Kishës së Nazaretit.
2. Ndryshimet në Nenet tona të Besimit duhet të kërkojnë studim të qëllimshëm dhe të plotë nga persona të kualifikuar, duke përfshirë teologë që pasyrojnë natyrën e denominacionit tonë mbarë botëror.
3. Ky studim duhet të bëhet para çdo veprimi të ndërmarr nga Asambleja e Përgjithshme.
4. Asambleja e Përgjithshme pasuese do t'i ketë përfitimet e këtij studimi së bashku me ndonjë rekomandim apo rezolutë të hulumtuar mirë, nëse është e nevojshme, të ndihmojë në marrjen e vendimit të saj.

¹⁸ The Cape Town Commitment: A Confession of Faith and a Call to Action (The Lausanne Movement, 2011).

5. Vendorsja e kësaj resolute Brenda Kushtetutës siguron se, sikur Nenet e Besimit, nuk do të jet subjekt i votës të një Asambleje të vetme të Përgjithshme.

Me respekt e parashtruar nga,
KOMISIONI I STUDIMEVE TË SHKRIMEVE

Thomas King, Kryetar

Alexander Varughese, Sekretar